




REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. / Dep. / Dep.	2-D/DPK
Nr. ffaq. / Broj stranica / Nr. pages	02
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.	01-3903/13
Data / Datum / Date	15.11.2013
PRISTINE	



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër korrupsionit me datë 11.11.2013, nxjerr këtë:

### V E N D I M

I, Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3041/13, për znj. *Mrika Kotorri-Këshilltare politike në Kabinetin e Kryeministrit të Kosovës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-3041-13, i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrтарen e lartë, z. Mrika Kotorri – Këshilltare politike në Kabinetin e Kryeministrit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-3041/13, të hetuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarja e lartë, znj. Kotorri së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër korrupsionit pas të cilës ajo është paraqitur në Agjencinë kundër korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të saj publik.

Zyrtarja e lartë, znj. Kotorri është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e saj publik, pa konflikt të interesit.

Ndërkohë, znj. Kotorri në Agjenci ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPK/DPKI-03-3784/13), në të cilën shihet se ajo ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar që kishte të biznesi individual N.Sh "Positive Gold", për të ushtruar vetëm funksionin e vet zyrtar si Keshilltare Politike në Kabinetin e Kryeministrit të Kosovës.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore i Agjencisë kundër korrupsionit

